



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE PERSONAVE ME AFTËSI
NDRYSHE

Nr. 1033 / Prot

Shkodër, më 16.01.2026

Lënda: Dërgim Projekt-Vendimi

KËSHILLIT BASHKIAK

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për miratim Projekt - Vendimin dhe Relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi ndryshe:

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%) PËR NDIHMËN EKONOMIKE.


KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETAR

Teuta Qyteza





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE PERSONAVE ME AFTËSI
NDRYSHE

Nr. 1033 Prot

Shkodër, më 16/01 .2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____ datë _____

Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës / / 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës:

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETAR

Teuta Çyfezu



**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO
TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).**

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle.
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare.
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor.
4	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle.
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor.
6	Familje në proces divorci.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata.
7	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim ngujimi nga gjakmarrja.
8	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	5	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë.
9	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	3	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata.
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare.

Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edita Shashi Shashi

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi Ndryshe

F. Biontani

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

G. Dava

Drejtoria Juridike

B. Kerpica



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE PERSONAVE ME AFTËSI
NDRYSHE**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

RELACION

Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.

Të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak,

Referuar dispozitave të ligjit Nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.597 datë 04.09.2019 " Për caktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar,

Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Familjet që synohen të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe që janë refuzuar nga sistemi i pikëzimit me arsyen “nuk ka marrë pikët e mjaftueshme”.

Për çdo familje që propozohet për trajtim nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%), duhet të kryhet paraprakisht vlerësimi social-ekonomik në familje nga administratori shoqëror, i cili dokumentohet dhe shërben si bazë për vendimmarrje. Përfitimi rishikohet periodikisht dhe ndërpritet në rast të përmirësimit të kushteve ekonomike ose humbjes së kritereve për përfitim.

Që nga implementimi i skemës së re të ndihmës ekonomike, është konstatuar se një numër i konsiderueshëm familjesh, ndonëse ndodhen në kushte të theksuara varfërie dhe përballen me problematika serioze sociale dhe ekonomike, nuk arrijnë të shpallen përfituese nga sistemi elektronik kombëtar për shkak të mosplotësisimit të pikëve. Për pasojë, këto familje

mbeten pa mbështetje ekonomike, duke rrezikuar përkeqësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës.

Me qëllim garantimin e trajtimit të drejtë, transparent dhe të orientuar drejt nevojës reale, është hartuar një tabelë kriteresh, e cila përcakton kategoritë përfituese, nivelin e pikëve për secilin kriter dhe dokumentacionin konfirmues.

Këto kritere synojnë të sigurojnë përzgjedhjen e familjeve më në nevojë, brenda kufirit të fondit shtesë të disponueshëm.

Bazuar në verifikimet e kryera nga Drejtoria e Ndihtmes Ekonomike dhe të personave me aftësi ndryshe, këto familje i përkasin kryesisht kategorive më të cenueshme, si:

- Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç.
- Familje me 1 ose 2 anëtarë të moshës mbi 50 vjeç, të cilët janë në pamundësi punësimi nga strukturat shtetërore mbështetëse, të pamundur për punë për arsye shëndetësore apo moshe.
- Familje me anëtarë mbi moshën e punës që nuk përfitojnë pension.
- Familje me pjesëtarë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar.
- Familje në proces divorci dhe përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale.
- Familje që kanë k/familjarin në burg.
- Familje me probleme të rënda sociale, përfshirë rastet e gjakmarrjes, etj.

Më poshtë kemi dhënë të detajuar tabelën e kriterëve që propozojmë për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%), të hartuar nga specialistët tanë.

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle.
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare.

3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor.
4	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim shkollë.
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor.
6	Familje në proces divorci.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata.
7	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim ngujimi nga gjakmarrja.
8	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	5	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë.
9	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	3	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata.
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare.

Ju ftojme që t'i merrni në konsideratë kriteret e hartuara nga administrata, në mënyrë që nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, të përfitojnë familjet më vulnerabel, të cilat janë refuzuara nga sistemi i pikëzimit (për mungesë pikësh).

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/ KRYETAR

Teuta Qyteza

